

Sigurim i Jetës së Kredimarrësit

Sigurimi i Jetës së kredimarrësit është një sigurim i cili lidhet me shumën e kredise së klientit.

Ky sigurim ofrohet për kredimarrësit e të gjitha institucioneve kredidhenese (Banka, Mikrofinanciare, etj.) të licencuara nga Banka Qendrore e Kosoves.

Sigurimi i jetës së kredimarrësit është një produkt sigurimi jete i cili ofrohet për personat të cilët marrin kredi në banka apo institucione mikrofinanciare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosoves dhe i mbron ata nga rreziku i pamundësisë së mosshlyerjes së kredise si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit.

Ky produkt garanton pagesën e shumës së pakthyer të kredise në momentin e humbjes së jetës së kredimarrësit.

Sigurimi i Jetës së kredimarrësit garanton familjen e të siguruarit apo ortakëve të biznesit nga detyrimi banker duke i liruar ata nga kjo barrë, pasi është SIGAL Life UNIQA që me rastin e humbjes së jetës së kredimarrësit, merr përsipër shlyerjen (pagesën) e shumës së mbetur të kredise, duke lehtësuar në këtë mënyrë detyrimin financiar që do të rëndonte mbi ta.

Efektet e sigurimit të jetës janë të shumëanshme pozitive. Duke qenë se me rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, kompania e sigurimit paguan shumën e mbetur të kredise, atëherë klienti lirohet nga përgjegjësitë dhe obligimet ndaj bankës, duke liruar po ashtu edhe kolateralët dhe hipotekat e lena për atë kredi në banka nga kredimarrësit apo garantuesit. Kështu, banka nuk ka nevojë të bejë shitjen e pronës së lenës për kredi dhe rrjedhimisht do të shmangë pasojat sociale po ashtu.

Mbulimi në sigurim

SIGAL Life UNIQA do t'i paguajë policëmbajtësit/përfituesit përfitimin e pagueshëm në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Sigurimi "Humbja e Jetës/Loss of Life" (nga të gjitha shkaqet, pra mbi bazën vetëm të përjashtimeve) - Siguruesi dhe Policëmbajtësi bien dakord që, kundrejt pagesës së primit Siguruesit dhe në përputhje me kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate, Siguruesi do t'i paguajë Përfituesit përfitimet në mënyrë(at) dhe kufirin(jtë) e përshkruara në kontratë, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, pasi Siguruesi ka marrë provat e duhura se i Siguruari ka vdekur gjatë periudhës që policia ka qenë në fuqi.

Ekzistojnë edhe mundësi të kombinimit të produkteve të ndryshme sipas kërkesave dhe mundësive të klienteve.

Avantazhet e produktit për Klientin:

- Mbrojtje e dyanshme Financiare
- Jete e rehatshme
- Cmim/Prim i volitshëm
- Procedure e thjeshtë dhe e shpejtë

Dokumentacione të tjera:

1. [Kërkesa për Sigurim Jete të Kredimarrësit](#)
2. [Deklarata Shendetsore](#)
3. [Kushtet e Përgjithshme](#)
4. [Analizat mjekësore \(sipas nevojës\)](#)